



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Rregulla ZRRE/Nr.04/2020

**RREGULLA PËR PËRCAKTIMIN E OPERATORIT TË EMËRUAR TË TREGUT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE (NEMO) PËR KRYERJEN E AKTIVITETEVE TË
NDËRLIDHURA ME BASHKIMIN E TREGUT DHE OPERIMIN E TREGUT TË
BASHKUAR**

Prishtinë, shtator 2020



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në pajtim me Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, Nenin 25, Nenin 26, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Nenin 21 dhe Nenin 22.7 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr.05/L-085 dhe bazuar në Rekomandimet e Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë të datës 24.04.2019, në mbledhjen e mbajtur me 30.09.2020, miratoi:

**RREGULLA PËR PËRCAKTIMIN E OPERATORIT TË EMËRUAR TË TREGUT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE (NEMO) PËR KRYERJEN E AKTIVITETEVE TË NDËRLIDHURA ME BASHKIMIN E
TREGUT DHE OPERIMIN E TREGUT TË BASHKUAR**

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Kjo Rregull përcakton kushtet dhe procedurat për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe revokimin e përcaktimit të tillë në Republikën e Kosovës nga Rregullatori.
2. Kjo Rregull përkufizon detyrat të cilat do t'i kryej Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike NEMO në Republikën e Kosovës në lidhje me procesin e bashkimit të tregut të energjisë elektrike.
3. Kjo Rregull përkufizon detyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) që do t'i kryej në lidhje me procesin e bashkimit të tregut të energjisë elektrike.

Neni 2

Përkufizimet

1. Termat e përdorura në këtë Rregull do të kenë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. **Aplikues** – është subjektit juridik që ka paraqitur aplikimin për tu përcaktuar si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).
 - 1.2. **CACM (Rregullorja)** – është “Rregullorja e Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestionëve” (CACM Regulation) e Komisionit të BE 2015/1222 të datës 24 korrik 2015 mbi krijimin e një udhëzuesi për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestionëve.



- 1.3. **Të ardhurat nga kongjestionet** - janë të ardhurat e pranuar si rezultat i alokimit të kapaciteteve;
- 1.4. **Algoritmi i bashkërendimit të tregtimit të vazhdueshëm** - është algoritmi i përdorur në bashkimin e tregut ndërditor për bashkërendimin e vazhdueshëm të porosive dhe alokimit të kapaciteteve ndër-zonale;
- 1.5. **Pała** - është subjekt juridik që ka për detyrë të nënshkruaj kontrata me pjesëmarrësit e tregut, duke zëvendësuar kontratat që rezultojnë nga procesi i bashkërendimit, si dhe organizimin e transferimit të gjendjeve neto që rezultojnë nga alokimi i kapaciteteve me palët tjera ose me agjentët e transferimit;
- 1.6. **Afati i tregut një-ditë-para (Day-Ahead)** - është afati kohor i tregut të energjisë elektrike deri në kohën e mbylljes së portës të tregut një-ditë-para, ku për çdo njësi kohe të tregut produktet tregtohen një ditë para liferimit (dorëzimit);
- 1.7. **Bashkimi i tregut një-ditë-para** - është procesi i ankandit ku porositë e mbledhura bashkërenditen dhe kapaciteti ndër-zonal alokohet në të njëjtën kohë për zona të ndryshme ofertimi në tregun një-ditë-para;
- 1.8. **Koha e mbylljes së portës të tregut një-ditë-para** – është pika kohore deri në të cilën porositë pranohen në tregun një-ditë-para;
- 1.9. **Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë** - (ECRB) i referohet Bordit Rregullator të organizatës ndërkombëtare që është formuar sipas Traktatit që themelon Komunitetin e Energjisë.
- 1.10. **Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE)** – është agjencia e pavarur për sektorin e energjisë, e themeluar sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
- 1.11. **Teprica ekonomike për bashkimin e tregut një-ditë-para ose ndërditor** - është shuma e: (i) tepricës të furnizuesit për periudhën relevante kohore në tregun e bashkuar një-ditë-para ose ndërditor, (ii) tepricës së konsumit për tregun e bashkuar një-ditë-para ose ndërditor, (iii) të ardhurave nga kongjestionet dhe (iv) kostot dhe përfitimet tjera të ndërlidhura kur këto rrisin eficiencën ekonomike për periudhën relevante kohore, ku teprica e furnizuesit dhe e konsumatorit është diferenca në mes porosive të pranuar dhe çmimit të tregut për njësi të energjisë të shumëzuar me vëllimin e energjisë elektrike të porosive;
- 1.12. **Afati kohor për tregut ndërditor (intraday)** - është afati kohor i tregut të energjisë elektrike pas kohës së hapjes së portës ndër-zonale ndërditore dhe para kohës së mbylljes së portës ndër-zonale ndërditore, ku për çdo njësi kohore të tregut, produktet tregtohen para liferimit të tyre;
- 1.13. **Bashkimi i tregut ndërditor** - është procesi i vazhdueshëm ku porositë e mbledhura bashkërenditen dhe kapaciteti ndër-zonal alokohet në të njëjtën kohë për zona të ndryshme ofertimi në tregun ndërditor;
- 1.14. **Koha e hapjes së portës ndër-zonale ndërditore** - është pika kohore kur kapaciteti ndër-zonal në mes të zonave ofertuese hapet për një njësi kohore të tregut të dhënë dhe për kufirin e dhënë të një zone ofertuese;
- 1.15. **Koha e mbylljes së portës ndër-zonale ndërditore** - është pika kohore kur alokimi i kapacitetit ndër-zonal nuk lejohet tutje për një njësi kohore të tregut të dhënë;



- 1.16. **Funksioni i Operatorit të Tregut të Bashkuar (OTB)** – është ndërmarrja e bashkërendimit të porosive nga tregjet një-ditë-para dhe ndërditor për zonat e ndryshme ofertuese dhe njëkohësisht alokimi i kapaciteteve ndër-zonale;
 - 1.17. **Bashkërendimi** - është mënyra e tregtimit përmes të cilës porositë e shitjeve bashkërendohen me porositë e duhur të blerjeve për të siguruar maksimizimin e tepricës ekonomike për bashkimin e tregut një-ditë-para ose ndërditor;
 - 1.18. **Monopoli legal kombëtar** - i referohet dhe është i definuar si i tillë në raste kur Ligji kombëtar përcakton emërimin e një subjekti juridik të vetëm për sigurimin e shërbimeve të tregtimit një-ditë-para dhe/ose ndërditor;
 - 1.19. **Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)** - i referohet subjektit juridik që është emëruar nga ZRRE për të kryer detyrat e ndërlidhura me bashkimin e tregut një-ditë-para dhe/ose ndërditor sipas kësaj Rregulle;
 - 1.20. **Kalkulimi i kapacitetit neto të transmetimit (NTC)** - është neto kapaciteti i transmetimit dhe nënkupton metodën e kalkulimit të kapacitetit të bazuar në principin e vlerësimit dhe definimit ex ante të këmbimit maksimal të energjisë midis zonave të afërta të ofertimit;
 - 1.21. **Oferta** – është synimi për të blerë ose shitur energji ose kapacitet të shprehur nga një pjesëmarrës i tregut që i nënshtrohet kushteve të përcaktuara të ekzekutimit;
 - 1.22. **Algoritmi i çmimit të tregut të bashkuar** - është algoritmi i përdorur në bashkimin e tregut një-ditë-para për bashkërendimin e ofertave dhe alokimin e kapaciteteve ndër-zonale në të njëjtën kohë;
 - 1.23. **Barazimi** - është plotësimi i një transaksioni ose i procesimit me qëllim të likuidimit të detyrimeve të pjesëmarrësve përmes transferit të fondeve dhe/ose garancive perkatëse;
 - 1.24. **Treg i organizuar i energjisë elektrike** - treg i organizuar në mënyrë institucionale një ditë para livrimit fizik dhe/ose gjatë ditës së livrimit fizik. Pjesëmarrësit në treg paraqesin ofertat dhe kërkesat e tyre për produkte të paracaktuara dhe të standardizuara të energjisë elektrike për çdo interval kohor një ditë para, ose gjatë ditës së livrimit fizik;
 - 1.25. **Agjent i transferimit** - është person fizik ose juridik që ka për detyrë transferimin e neto pozicioneve në mes të palëve të ndryshme;
 - 1.26. **Operatori i Sistemit të Transmetimit - (OST)** është subjekt juridik që është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe për zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë të caktuar.
 - 1.27. **Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu – (KOSTT)** – është subjekt juridik i licencuar nga Rregullatori dhe është përgjegjës për të operuar sistemin e transmetimit të Kosovës.
2. Termat tjerë të përdorur në këtë Rregull kanë kuptimin si në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Energji dhe ligjet tjera në fuqi në Republikën e Kosovës.



Neni 3

Përcaktimi dhe revokimi i emërimit të NEMO

1. Aplikimi për ushtrimin e aktiviteteve të NEMO në Republikën e Kosovës duhet të plotësohet dhe dorëzohet në ZRRE në formë të shkruar siç është përcaktuar në Shtojcën 1.a të kësaj Rregulle në një (1) kopje fizike origjinale dhe një (1) kopje elektronike në CD.
2. Aplikuesi duhet të përdorë formatin e bashkangjitur në Shtojcën 1.a. të kësaj Rregulle për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve të renditura në Nenin 4 të kësaj Rregulle dhe duhet të dorëzoj dokumentet e renditura në Shtojcën 1.b të kësaj Rregulle.
3. Pas pranimit të kërkesës/aplikimit për emërimin e NEMO, ZRRE do të marr Vendim për emërimin e NEMO si monopol kombëtar për shërbimet e tregtimit një-ditë-para dhe ndërditor brenda afatit 2 [dy] muajor nga data e aplikimit dhe kompletimit të aplikacionit.
4. Në rast se ka disa aplikues për tu emëruar si NEMO i vetëm, ZRRE do të emëroj aplikuesin që i përmbushë më se miri kriteret e përcaktuara në Nenin 4 të kësaj Rregulle. Vendimi duhet të merret në mënyrë transparent dhe jo-diskriminuese.
5. ZRRE mund të revokojë emërimin nëse NEMO i emëruar në pajtim me Vendimin për emërim dështon të përmbush obligimet e përcaktuara në Nenin 4 të kësaj Rregulle dhe nuk është në gjendje që të korrigjoj përmbushjen e këtyre obligimeve brenda gjatë (6) muajve prej kur njoftohet për një dështim të tillë nga ZRRE.
6. ZRRE do të publikoj vendimin për emërimin dhe/ose revokimin e NEMO në faqen elektronike zyrtare dhe do të njoftojë ECRB.
7. ZRRE do të aprovoj tarifën e mjaftueshme për NEMO për tregtim në tregjet një-ditë-para dhe ndërditore, para se të fillojë funksionimin si NEMO, ose do të specifikoj metodologjitë e përdorura për kalkulimin e tyre.

Neni 4

Kriteret e përcaktimit të NEMO

1. Aplikuesi do të emërohet si NEMO vetëm nëse i përmbush kërkesat si më poshtë:
 - 1.1. ka kontraktuar ose kontraktuar burimet e duhura për operimin e përbashkët, të koordinuar dhe të pajtueshëm të tregut të përbashkët një-ditë-para dhe/ose ndërditor, përfshirë burimet e nevojshme për përmbushjen e funksioneve të NEMO, burimet financiare, teknologjinë informative të nevojshme, infrastrukturën teknike dhe procedurat operacionale ose duhet të ofrojë dëshmi se është në gjendje që të vë në dispozicion këto burime brenda një *periudhë të arsyeshme përgatitore* para se të filloj detyrat e veta në pajtim me Nenin 5 të kësaj Rregulle;
 - 1.2. duhet të jetë në gjendje që të siguroj se pjesëmarrësit e tregut kanë qasje të hapur në informata në lidhje me detyrat e NEMO në pajtim me Nenin 5 të kësaj Rregulle;
 - 1.3. duhet të operoj me *kosto efçiente* në lidhje me bashkimin e tregut një-ditë-para dhe ndërditor dhe duhet që në kontabilitetin e brendshëm të ketë llogari të ndara për funksionet e Operatorit të Tregut të Bashkuar (OTB) dhe aktivitetet tjera në mënyrë që të parandaloj ndërsubvencionimin;
 - 1.4. duhet të ketë aktivitet të ndarë nga pjesëmarrësit tjerë të tregut;



- 1.5. nuk do të përdorë tarifat e Nenit 3 paragrafi 7 të kësaj Rregulle për të financuar aktivitetet e veta të tregut një-ditë-para ose ndërditor në një Palë tjetër, përveç palës nga e cila ka mbledhur/marrë këto tarifa;
- 1.6. duhet të trajtoj të gjithë pjesëmarrësit e tregut në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese;
- 1.7. duhet të ketë rregulla dhe organizim të përshtatshëm për mbikëqyrjen e tregut;
- 1.8. duhet të vendos marrëveshje të duhur për transparencë dhe konfidencialitet me pjesëmarrësit e tregut dhe KOSTT;
- 1.9. duhet të ofrojë shërbimet e nevojshme të likuidimit dhe barazimit; dhe
- 1.10. duhet të vendos sistemin e nevojshëm të komunikimit dhe praktikat për koordinim me KOSTT.

KAPITULLI II

DETYRAT DHE FUNKSIONET

Neni 5

Detyrat e NEMO

1. Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) duhet të veprojë si operator i tregut në Kosovë ose tregjet rajonale për të kryer, në bashkëpunim me KOSTT dhe OST rajonale, bashkimin e tregut një-ditë-para dhe ndërditor. Detyrat e tij do të përfshijnë pranimin e porosive nga pjesëmarrësit e tregut, duke pasur përgjegjësinë e përgjithshme për bashkërendimin dhe alokimin e porosive në pajtim me rezultatet e bashkimit të tregut një-ditë-para dhe ndërditor, duke publikuar çmimet dhe shlyerjen dhe barazimin e kontratave që rezultojnë nga tregtimet sipas marrëveshjeve dhe rregulloreve relevante të pjesëmarrësve.
2. Në lidhje me bashkimin e tregut një-ditë-para dhe ndërditor, NEMO do të jetë në veçanti përgjegjës për detyrat në vijim:
 - 2.1. implementimin e funksioneve të OTB të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij Neni në koordinim me NEMO tjera;
 - 2.2. implementimin e kërkesave për bashkimin e tregut një-ditë-para dhe ndërditor, kërkesat për funksionet e OTB dhe algoritmin e çmimit të bashkimit sipas algoritmit të vendosur dhe që aplikohet në vendet e BE në lidhje me të gjitha çështjet e ndërlidhura me funksionimin e tregut të energjisë elektrike në pajtim me paragrafin 3 të këtij Neni;
 - 2.3. implementimin e çmimeve maksimale dhe minimale siç janë të përcaktuara në nivel të BE në pajtim me çmimet maksimale dhe minimale të caktuara në nivel të BE ose nivelet rajonale;
 - 2.4. ruajtjen e anonimitetit, në atë mënyrë që nuk mund t'i atribuohet një pjesëmarrësi të veçantë të tregut dhe nuk do të zbuloj informacionet për porosinë e pranuar të shprehur në Euro, të nevojshme për të kryer funksionet e OTB të përmendur në paragrafin 3 të këtij Neni;
 - 2.5. vlerësimin e rezultateve të kalkuluara bazuar në funksionet e OTB të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij Neni, alokimin e porosive bazuar në këto rezultate, vërtetimin e rezultateve si përfundimtare nëse ato konsiderohen si të sakta dhe dorëzimin e tyre te OST, të cilët duhet t'i vërtetojnë ato në pajtim me mundësitë e alokimit të kapacitetit ndër-zonal të disponueshëm;



- 2.6. informimin e pjesëmarrësve të tregut mbi rezultatet e ofertave të tyre pa ndonjë vonesë të pajustificueshme;
 - 2.7. të veprojë si palë për shlyerjen dhe barazimin e shkëmbimit të energjisë që rezultojnë nga bashkimi i tregut një-ditë-para dhe ndërditor sipas metodologjisë e hartuar në vendet e BE;
 - 2.8. të miratoj dhe implementoj së bashku me NEMO dhe OST relevante procedurat rezerve (back-up) për operimin e tregut kombëtar ose rajonal nëse nuk ka rezultate në dispozicion nga funksionet e OTB, duke marrë parasysh procedurat rezervë (fallback) të dakorduara nga OST. Këto procedura rezervë duhet të lejojnë në nivel kombëtar dhe rajonal alokimin e kapacitetit në rast kur proceset e bashkimit të tregut nuk janë në gjendje të japin rezultate;
 - 2.9. të siguroj parashikimin e kostove për bashkimin e tregut një-ditë-para dhe ndërditor për autoritetet kompetente rregullatore dhe OST në raste ku kostot e NEMO për krijimin, ndryshimin dhe operimin e bashkimit të tregut një-ditë-para dhe ndërditor do të mbulojnë nga kontributet e OST në fjalë;
 - 2.10. të kryej rolin e agjentit të transferimit, nëse vendoset nga ZRRE.
3. NEMO do të kryej funksionet e OTB së bashku me NEMO tjera. Këto funksione duhet të përfshijnë si në vijim:
- 3.1. implementimin e algoritmeve, sistemeve dhe procedurave për bashkimin e tregut një-ditë-para dhe/ose ndërditor siç është e përcaktuar në nivel të BE. Nëse bashkimi i tregut në mes të dy apo më shumë zonave të ofertimit nuk përfshinë ndonjë Shtet Anëtar të BE në hapin e parë, mund të arrihet dhe implementohet një zgjidhje e përkohshme, që i nënshtrohet aprovimit nga ZRRE dhe në bashkëpunim të ngushtë me OST dhe NEMO tjera të përfshira, në këto kushte krijohet mundësia që algoritmet, sistemet dhe procedurat për bashkimin e tregut një-ditë-para dhe/ose ndërditor që aplikohen në BE të zbatohen edhe në këtë rast dhe për aq sa është e mundur, ndërkohë duke lejuar veçantitë e dy zonave ofertuese;
 - 3.2. përpunimin e të dhënave hyrëse mbi kapacitetin ndër-zonal si dhe kufizimet e alokimeve që ofrohen në procesin e kalkulimit të koordinuar të kapacitetit nga OST ose kalkulatorit të koordinuar të kapacitetit që vepron në emër të OST. Këto të dhëna hyrëse duhet të dorëzohen te NEMO përkatëse jo më vonë se një orë para kohës së mbylljes së tregut një-ditë-para dhe jo më vonë se 15 minuta para kohës së hapjes së portës ndër-zonale ndërditor;
 - 3.3. operimi i çmimeve të përbashkëta dhe algoritmet e bashkërendimit të vazhdueshëm të tregtimit siç janë përcaktuar në nivel të BE. Nëse bashkimi i tregut në mes të dy ose më shumë zonave të ofertimit nuk përfshinë ndonjë Shtet Anëtar të BE në hapin e parë, mund të arrihet dhe implementohet një zgjidhje e përkohshme që i nënshtrohet aprovimit nga ZRRE dhe në bashkëpunim të ngushtë me OST dhe NEMO tjera të përfshira, në këto kushte krijohet mundësia që algoritmet e aplikuar në BE të zbatohen edhe në këtë rast dhe për aq sa është e mundur, ndërkohë duke lejuar veçantitë e dy zonave ofertuese;
 - 3.4. verifikimi dhe dërgimi i rezultateve të bashkimit të tregut një-ditë-para dhe ndërditor tek NEMO dhe OST.
4. Bashkëpunimi në mes të NEMO-ve do të kufizohet vetëm në atë pjesë që është e nevojshme për hartimin, implementimin dhe operimin efikas dhe të sigurt të bashkimit të tregut një ditë-para dhe ndërditor. Performanca e përbashkët e funksioneve të OTB do të bazohet në parimin e jo-diskriminimit dhe do të siguroj që asnjë NEMO të mos mund të përfitoj nga avantazhet e paarsyeshme ekonomike përmes pjesëmarrjes në funksionet e OTB. Kjo në masë të madhe duhet të reflektoj dhe me këtë të ndaloj përdorimin e informatave të zotëruesit, që nuk janë në



dispozicion për publikun, nga ana e NEMO që do të jepte një avantazh të padrejtë ndaj konkurrentëve ekzistues ose potencial ose përdorimin për të maksimizuar përfitimin ekonomik.

Neni 6

Detyrat e KOSTT që ndërlidhen me bashkimin e tregut një-ditë-para dhe ndërditor

1. Pasi që është emëruar NEMO në Kosovë sipas Nenit 3.3 të kësaj Rregulle, KOSTT duhet të merr pjesë në bashkimin e tregut një-ditë-para dhe ndërditor. KOSTT duhet të koordinohet me NEMO për të siguruar implementimin efikas të bashkimit të tregut.
2. Detyrat që KOSTT duhet të kryej janë si në vijim:
 - 2.1. të punojë për së afërmi me OST nga Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe/ose Shtetet Anëtare të BE për të siguruar funksionimin e një çmimi të përbashkët dhe algoritmeve të bashkërendimit të vazhdueshëm të tregtimit për të gjitha aspektet e ndërlidhura me alokimin e kapaciteteve siç janë të përcaktuara në standardet e BE;
 - 2.2. të kontribuoj në miratimin e përbashkët të algoritmeve të bashkërendimit kundrejt kërkesave siç janë të përcaktuara në standardet e BE;
 - 2.3. në bashkëpunim me OST tjera të kryej kalkulimin e Kapacitetit Neto (NTC) për D-2 ditë për të mbështetur bashkimin e tregut;
 - 2.4. të kalkuloj, të konfirmoj me OST tjera dhe të dërgoj kapacitetet ndër-zonale dhe kufizimet e alokimeve të NEMO relevante jo më vonë se 1 orë para mbylljes së portës për tregjet një-ditë-para. Nëse OST nuk janë në gjendje që të ofrojnë këto të dhëna atëherë duhet të njoftoj NEMO relevante dhe duhet të ofroj këto të dhënat jo më vonë se 30 minuta para mbylljes së portës së tregut një-ditë-para;
 - 2.5. të verifikoj rezultatet e bashkimit të tregut të një-ditë-para në lidhje me kapacitetet ndër-zonale dhe kufizimeve të alokimeve;
 - 2.6. të respektojë rezultatet nga bashkimi i tregut një-ditë-para dhe ndërditor të kalkuluara sipas paragrafit 2, nënparagrafi 2.5 të këtij Neni;
 - 2.7. të krijojë dhe aplikoj procedurat mbështetëse siç është e përshtatshme për alokimin e kapaciteteve;
 - 2.8. të pajtohet me OST tjera dhe të propozoj kohën e hapjes së portës ndër-zonale për tregun ndërditor dhe kohën e mbylljes së portës ndër-zonale të ofertave për tregun ndërditor në pajtim me metodologjitë e aplikuar në BE;
 - 2.9. të ndajë të ardhurat e kongestionit në pajtim me metodologjinë e miratuar me OST tjera relevante që janë në pajtim me metodologjitë e BE;
 - 2.10. aty ku është rënë dakord, të veproj si agjent transferimi për transferimin e neto pozicioneve në treg.
 - 2.11. të kryej rolin e agjentit të transferimit nëse është vendosur nga Rregullatori.



KAPITULLI III

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 7

Kohëzgjatja e emërimit

Emërimi i NEMO sipas Neni 3 të kësaj Rregulle do të mbetet i vlefshëm deri në përfshirjen e Rregullores CACM në legjislacionin primar të Republikës së Kosovës e pastaj emërimi i NEMO do të konfirmohet në pajtim me rregullat e Rregullores së CACM.

Neni 8

Ndryshimet

1. Rregullatori mund të ndryshojë ose modifikoj çdo dispozitë të kësaj Rregulle.
2. Procedura e ndryshimit apo modifikimit të kësaj Rregulle do të jetë e njëjtë me atë të aprovimit të saj.

Neni 9

Interpretimi

Nëse ka paqartësi rreth dispozitave të kësaj Rregulle, Bordi i Rregullatorit do të ofroj informata sqaruese.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Rregull hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të ZRRE.

Bordi i ZRRE-së,


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Serifijaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar



Shtojca 1.a

Formulari i formatit të aplikimit

1. Informatat mbi subjektin juridik:

- a) Emri i aplikuesit: [vendos emrin e subjektit]
- b) Adresa e aplikuesit: [vendos adresën e aplikuesit]

2. Informatat kontaktuese për aplikuesin

- a) Emri i personit kontaktues: [vendos emrin e personit kontaktues]
- b) Pozita e personit kontaktues: [vendos pozitën e mbajtur nga personi kontaktues]
- c) Numri i telefonit të personit kontaktues: [vendos numrin e telefonit të personit kontaktues]
- d) Adresa e email-it të personit kontaktues: [vendos adresën e email-it të personit kontaktues]
- e) Adresa postare e personit kontaktues: [vendos adresën postare të personit kontaktues]

3. Deklarata nëse aplikuesi është duke aplikuar për emërim si NEMO [emri i palës kontraktuese] për bashkim të tregut një-ditë-para dhe/ose ndërditor:

[Subjekti] është duke aplikuar për emërim si NEMO në Kosovë për të operuar në tregun e përbashkët një-ditë-para dhe ndërditor.

Nëse ekziston më shumë se një zonë ofertuese tregoni se për cilën zonë ofertuese po bëhet aplikimi:

[Nëse është e aplikueshme, vendosni se për cilën zonë të ofertimit është ky aplikim]

4. A ka aplikuar aplikuesi për përcaktim të NEMO te ndonjë palë tjetër dhe nëse po te cila palë/zonë ofertuese:

[Nëse është e aplikueshme, vendos emrin e palës dhe zonës ofertuese për të cilën subjekti ka aplikuar]

A është refuzuar ndonjë aplikacion, nëse po tek e cila palë dhe për çfarë arsye:

[Vendos palën dhe arsyen e refuzimit]

5. Deklarata nëse subjekti është aktiv si monopol legal në një treg tjetër: [Fshijë sipas nevojës]

[Subjekti] nuk është aktiv si monopol legal në një treg tjetër/[Subjekti] është aktiv si monopol legal në [vendos tregun].

6. Deklarata nëse i gjithë ose një pjesë e aplikimit është konfidencial, arsyet pse dhe cila pjesë:

a) A përmban aplikimi informata konfidenciale:

[Fshijë sipas nevojës] Po/Jo

b) A është i gjithë apo një pjesë e aplikimit konfidencial:

[Fshijë sipas nevojës] I gjithë/një pjesë e aplikimit është konfidencial.

Nëse vetëm një pjesë e aplikimit është konfidenciale ju lutem nënvizoni ato në tekst ku paraqiten.

c) Arsyetimi i konfidencialitetit:

[Vendos arsyetimin e konfidencialitetit]

7. Nënshkrimi dhe deklarata për saktësinë e informatave të dorëzuara:



Unë, [vendos emrin], jam autorizuar që të dorëzoj aplikimin për emërim si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe garantoj se informatat dhe dokumentet e dorëzuara si pjesë e këtij aplikimi janë të vërteta, të sakta dhe përfshijnë të gjitha informatat relevante që janë të njohura për [Subjekti] në mënyrë që ZRRE të vlerësoj aplikimin e [Subjektit].

[Nënshkrimi, emri i nënshkruesit të autorizuar dhe pozita, vendi dhe data]

Lista e dokumenteve të dorëzuara si pjesë e këtij aplikimi:

[Rendit dokumentet]



Shtojca 1.b

Interpretimi i Nenit 4 dhe dokumenteve mbështetëse të ndërlidhura që duhet të dorëzohen në përputhje me të, duke marrë parasysh shembujt e praktikave më të mira nga Shtetet Anëtare të BE

Kriteret e përcaktuara në Nenin 4, par.1 – nënpar. 1.1:

Aplikuesi ka kontraktuar ose kontraktin burimet e duhura për operimin e përbashkët, të koordinuar dhe të pajtueshëm të tregut të përbashkët një-ditë-para dhe/ose ndërditor, përfshirë burimet e nevojshme për përmbushjen e funksioneve të NEMO, burimet financiare, teknologjinë informative të nevojshme, infrastrukturën teknike dhe procedurat operacionale ose duhet të ofrojë dëshmi se është në gjendje që të vë në dispozicion këto burime brenda një *periudhë të arsyeshme përgatitore* para se të filloj detyrat e veta.

Interpretimi i kuptimit:

Aplikuesit duhet të përfshijnë informata që kanë të bëjnë me:

- Të ketë kapital të mjaftueshëm dhe siguri financiare për të mbuluar shpenzimet për aktivitetet e veta dhe ekspozimin ndaj rrezikut në mënyrë që të operoj bashkimin e tregut eficient, të besueshëm dhe të qëndrueshëm të tregut të një-ditë-para dhe/ose ndërditor;
- Të ketë platformën e nevojshme për përdorim dhe bashkëveprim përkatës, përfshirë teknologjinë informative të nevojshme (softuer), pajisje teknike (harduer dhe infrastrukturë) dhe ose marrëveshje për nivel të shërbimeve kontraktuale për ofrimin e këtyre shërbimeve, së bashku me planin për emergjencë (contingency), që të operoj në mënyrë eficiente, të besueshme dhe stabile në bashkimin e tregut të një-ditë-para dhe/ose ndërditor;
- Të ketë marrëveshjet e nevojshme operacionale dhe kontraktuale me NEMO-të, OST-të dhe pjesëmarrësit tjerë përkatës të tregut si dhe plane të emergjencës për raste emergjente, që demonstronin se si NEMO do të kryej detyrat e veta të caktuara:

Dokumentet e nevojshme si dëshmi:

Sipas rastit, nga aplikuesi pritet që të dorëzoj dokumentet mbështetëse si në vijim:

1. Certifikatën e regjistrimit;
2. Deklaratën se kupton mjaftueshëm legjislacionin relevant;
3. Raportin e fundit vjetor të audituar;
4. Planin financiar që projekton të ardhurat e vitit aktual dhe të ardhshëm që nevojiten për kryerjen e detyrave të NEMO i cili përfshinë:
 - a. Pasqyrën e bilancit;
 - b. Pasqyrën e fitimit-humbjes;
 - c. Analizën e kapitalit;
 - d. Deklaratë e qartë mbi supozimet që janë përdorur për projeksionet;
 - e. Një analizë e ndjeshmërisë mbi projeksionet duke marrë parasysh ndryshimet në supozime;
 - f. Një analizë e qartë e mënyrës së si aplikuesi planifikon të financoj operimin përfshirë detajet e çfarëdo garancie të dhënë për aplikuesin.
5. Një Plan i Biznesit që ka të bëjë me detyrat e NEMO e që përfshinë:
 - a. Analizë e detajuar operacionale përfshirë proceset kryesore;



- b. Përshkrim dhe shpjegim të qartë se si do të operoj me bashkimin e tregut një-ditë-para dhe/ose ndërditor, përfshirë strukturën organizative;
- c. Strukturën organizative përfshirë personelin – burimet njerëzore për operim dhe në veçanti që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve të TI;
- d. Kodin e sjelljes dhe programin e pajtueshmërisë;
- e. Synimin, natyrën dhe fushëveprimin e caktimit të detyrave që do të ekzekutohen nga palët e treta dhe procedurat të cilat aplikuesi synon t'i implementoj për të siguruar ofrimin e shërbimit nga palët e treta;
- f. Shpjegim i detajuar i sistemit teknik dhe të TI që synohet të përdoret dhe besueshmëria operacionale e sistemit në fjalë;
- g. Aplikuesi duhet të paraqes masat me të cilat do të identifikoj dhe menaxhoj ose shmang konfliktin e interesit;
- h. Shpjegim të detajuar mbi planin se si aplikuesi synon të bashkëpunoj me NEMO dhe OST tjera dhe të dokumentoj se çfarëdo marrëveshje do të jetë në fuqi jo më vonë se 2 muaj pasi që të jetë aprovuar si NEMO i emëruar;
- i. Shpjegim i detajuar në lidhje me procesin e vendosur për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet si dhe planifikimin e përshtatshëm të menaxhimit të rasteve emergjente.

Kriteret e përcaktuara në Nenin 4 par.1 nënpar. 1.2:

Duhet të jetë në gjendje që të siguroj se pjesëmarrësit e tregut kanë qasje të hapur në informata në lidhje me detyrat e NEMO në pajtim me Nenin 5.

Interpretimi i kuptimit:

Aplikuesi duhet të vërtetoj dhe siguroj se do të jetë në gjendje që të publikoj informatat dhe të dhënat në mënyrë të hapur (d.m.th. marrëveshjet, metodologjitë, rregullat, procedurat dhe të dhënat) ashtu siç kërkohet, dhe që qasja do të jetë në dispozicion në mënyrë të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit e tregut.

Dokumentet e nevojshme si dëshmi:

Sipas rastit, aplikuesi pritet që të dorëzoj dokumentet mbështetëse si në vijim:

1. Një strategji të qartë të komunikimit që përfshinë:

- a. Përshkrimin dhe dëshminë se ku dhe si mund të qasen në informata pjesëmarrësit e tregut;
- b. Procesin e publikimit të të dhënave;
- c. Përshkrimin e planifikimit për rastet emergjente dhe garancia se këto informata janë në dispozicion për të gjithë pjesëmarrësit e tregut.

Kriteret e përcaktuara në Nenin 4 par.1 nënpar. 1.3:

Duhet të operoj me *kosto efiçiente* në lidhje me bashkimin e tregut një-ditë-para dhe ndërditor dhe duhet që në kontabilitetin e brendshëm të ketë llogari të ndara për funksionet e Operatorit të Tregut të Bashkuar (OTB) dhe aktivitetet tjera në mënyrë që të parandaloj ndër-subvencionimin.

Interpretimi i kuptimit:

Aplikuesi duhet të përfshij dëshmi se ka llogari të ndara për funksionet e Operatorit të Tregut të Bashkuar (OTB) dhe aktivitetet tjera të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe duhet të bëjë një analizë të qartë të të gjitha kostove të tyre për NEMO. Kjo do t'i mundësoj që



ZRRE të përcaktoj se në çfarë niveli ofrimi i shërbimeve është me kosto efiçiente. Kjo mund të bëhet qoftë përmes krahasimit me aplikuesit tjerë, nëse paraqiten më shumë se një aplikues, qoftë përmes bashkëpunimit me Autoritetet tjera Rregullatore të cilat kanë emëruar NEMO në të kaluarën.

Dokumentet e nevojshme si dëshmi:

Sipas rastit, aplikuesi pritet që të dorëzoj dokumentet mbështetëse si në vijim:

1. Përshkrimin dhe shpjegimin e qartë të proceseve të llogaritjes që do t'i lejonte aplikuesit të identifikoj dhe ndajë kostot e OTB dhe NEMO;
2. Përshkrimin dhe shpjegimin e qartë mbi llogaritë e ndara që do të përdoren për kostot e OTB dhe NEMO;
3. Përshkrimin e qartë të proceseve për të raportuar një ndarje të qartë të të gjitha kostove të NEMO, përfshirë kostot e OTB;
4. Një krahasim i kostove të aplikuesit në raport me shembujt e BE e ndarë sipas secilës kosto të NEMO dhe OTB.

Kriteret e përcaktuara në Nenin 4, par.1, nënpar. 1.4:

Aplikuesi duhet të ketë nivel adekuat të ndarjes së biznesit nga pjesëmarrësit tjerë të tregut.

Interpretimi i kuptimit:

Aplikuesi duhet të përfshijë dëshmi të ndarjes së mjaftueshme deri në atë masë që çfarëdo biznesi i ndërlidhur nuk do të jetë në gjendje të përdorë informatat e NEMO dhe OTB që nuk janë të hapura për publikun për avantazhin e tyre të padrejtë. Kjo nënkupton që aplikuesi duhet të përfshijë, për transparencë, çfarëdo konflikti potencial të interesit që del nga pronësia ose ndërlidhja me pjesëmarrësit e tregut. Kjo do të thotë se aplikuesi nuk duhet të ndajë informacionin me ose pa qëllim për të favorizuar një pjesëmarrës të tregut i cili mund të jetë pronar ose të ketë lidhje me aplikuesin. Përveç kësaj, nëse aplikuesi ka konflikt potencial të interesit, atëherë aplikuesi duhet të paraqes një proces dhe mekanizëm për të siguruar ndarjen e mjaftueshme dhe eliminimin e konfliktit të interesit.

Dokumentet e nevojshme si dëshmi:

Sipas rastit, aplikuesi pritet që të dorëzoj dokumentet mbështetëse si në vijim:

1. Përshkrim dhe shpjegim i qartë i strukturës të aplikuesit duke përfshirë, përbërjen e bordit ose organeve tjera qeverisëse dhe drejtorëve si dhe, nëse është e mundur, interesin e tyre në treg pavarësisht lidhjes së tyre me aplikuesin;
2. Informatat në lidhje me bizneset e tjera të mundshme të aplikuesit përveç shërbimeve të tregtimit një-ditë-para dhe ndërditor;
3. Deklaratë në lidhje me atë nëse aplikuesi është duke bashkëpunuar me palët tjera, dhe nëse po, cilat aktivitete është duke i ndërmarrë aplikuesi me këto palë;
4. Një përmbledhje të plotë të të gjitha institucioneve në vartësi funksionale të pjesëmarrësve tjerë të tregut;
5. Informatat në lidhje me përbërjen dhe identitetin e zotëruesve direkt dhe indirekt, palët tjera të ndërlidhura ligjërisht, kompanitë amë dhe filialet e tyre;
6. Në raste se aksionarët, palët tjera të ndërlidhura ligjore, kompanitë amë ose filialet janë pjesëmarrës të tregut, duhet një shpjegim se si aplikuesi e ka organizuar ndarjen e biznesit dhe eliminimin e konfliktit të interesit.

Kriteret e përcaktuara në Nenin 4, par.1, nënpar. 1.5:



Nëse aplikuesi është përcaktuar si monopol legal kombëtar për shërbimet e tregtimit një-ditë-para dhe ndërditor të një Palë Kontraktuese, atëherë nuk do të përdorë tarifën e Nenit 5(1) për të financuar aktivitetet e veta në tregun një-ditë-para ose ndërditor në një Palë Kontraktuese tjetër përveç palës nga e cila ka mbledhur/marrë këto tarifa.

Interpretimi i kuptimit:

Aplikuesi duhet, nëse është i përcaktuar si monopol kombëtar, të paraqes dokumentacionin që vërteton se ka llogari të veçanta për shërbimet e ofruara si monopol legal kombëtar për shërbimet e tregtimit në tregun një-ditë-para dhe ndërditor nga çfarëdo aktiviteti tjetër.

Dokumentet e nevojshme si dëshmi:

Sipas rastit, aplikuesi pritet që të dorëzoj dokumentet mbështetëse si në vijim:

1. Përshkrim dhe shpjegim të qartë të proceseve të tyre të llogaritjes për secilin aktivitet të monopolit legal.

Kriteret e përcaktuara në Nenin 4, par.1 nënpar. 1.6:

Aplikuesi duhet të jetë në gjendje që të trajtoj të gjithë pjesëmarrësit e tregut në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese

Interpretimi i kuptimit:

Aplikuesi duhet të paraqes dëshmi se ata mund dhe do të trajtojnë të gjithë pjesëmarrësit e tregut në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese. Kjo duhet të përfshijë procedura të cilat mundësojnë që pjesëtarët e rinj në treg të lejohen të hyjnë në treg me të njëjtat marrëveshje siç aplikohen për pjesëmarrësit ekzistues të tregut.

Dokumentet e nevojshme si dëshmi:

Sipas rastit, aplikuesi pritet që të dorëzoj dokumentet mbështetëse si në vijim:

1. Një shpjegim të detajuar të procedurave për pjesëmarrësit e tregut të bashkuar dhe që do të përdorin shërbimet e aplikuesit të cilat nuk do të lejojnë diskriminimin e pjesëmarrësve në treg;
2. Rregullat e tregut që do të aplikohen për të gjithë pjesëmarrësit e tregut duhet të sigurojnë se nuk do të ketë diskriminim në treg;
3. Procedurat e brendshme duhet të përcaktohen me shkrim në atë mënyrë që marrëveshjet operationale, marrëveshjet kontraktuale dhe shërbimet për pjesëmarrësit e tregut të mos jenë diskriminuese.

Kriteret e përcaktuara në Nenin 4, par.1, nënpar. 1.7:

Duhet të ketë rregulla dhe organizim të përshtatshëm për mbikëqyrjen e tregut

Interpretimi i kuptimit:

Aplikuesit duhet të vërtetojnë se ata kanë zbatuar ose do të zbatojnë një program trajnimi dhe procedura të monitorimit të cilat do të lejojnë aplikuesit të identifikojnë dhe raportojnë çfarëdo çështje potenciale që lidhet me integritetin e tregut të energjisë elektrike me shumicë dhe parimet e ndërlidhura të transparencës dhe jo-diskriminimit.

Dokumentet e nevojshme si dëshmi:

Sipas rastit, aplikuesi pritet që të dorëzoj dokumentet mbështetëse si në vijim:

1. Shpjegim i detajuar për programin e trajnimit përfshirë:



- a. Menaxhmenti dhe punëtorët kanë ose do të përvetësojnë njohuri mbi marrëveshjet e mbikëqyrjes së tregut;
 - b. Menaxhmenti dhe punëtorët janë ose do të jenë në dijeni për çështjet e mundshme të mbikëqyrjes së tregut, p.sh. çështjet REMIT;
 - c. Menaxhmenti dhe punëtorët janë në dijeni të përgjegjësive të tyre për të raportuar çështjet e mundshme gjatë mbikëqyrjes së tregut.
2. Shpjegim të qartë dhe të detajuar të skemës monitoruese dhe procedurave që lidhen me:
- a. mbajtjen e të dhënave;
 - b. monitorimin e aktiviteteve tregtuese;
 - c. identifikimin e rasteve të mundshme;
 - d. vlerësimin dhe hulumtimin e rasteve të mundshme;
 - e. Vlerësimin e përshkallëzuar të rasteve të mundshme të brendshme duke bashkëpunuar me autoritetet relevante;
 - f. përcaktimin se kush brenda subjektit do të mbajë përgjegjësinë kryesore për këto procedura dhe nëse për këtë qëllim do të krijohet një njësi e veçantë.

Kriteret e përcaktuara në Nenin 4, par.1, nënpar. 1.8:

Duhet të vendos marrëveshje të duhur për transparencë dhe konfidencialitet me pjesëmarrësit e tregut dhe KOSTT

Interpretimi i kuptimit:

Aplikuesit duhet të vërtetojnë se ata kanë ose do të implementojnë ose do të nënshkruajnë së bashku me pjesëmarrësit tjerë relevant të tregut dhe OST marrëveshje të cilat përfshijnë transparencën dhe konfidencialitetin e të gjitha palëve të përfshira.

Dokumentet e nevojshme si dëshmi:

Sipas rastit, aplikuesi pritet që të dorëzoj dokumentet mbështetëse si në vijim:

1. Përshkrim të detajuar për atë se si aplikuesi do të vlerësoj, miratoj dhe implementoj marrëveshjet për transparencë dhe konfidencialitet me pjestarët e tanishëm dhe të ardhshëm të tregut dhe OST;
2. Të dorëzoj çfarëdo marrëveshje ekzistuese që është e aplikueshme.

Kriteret e përcaktuara në Nenin 4, par.1, nënpar. 1.9:

Duhet të jetë në gjendje që të ofrojë shërbimet e nevojshme të likuidimit dhe barazimit

Interpretimi i kuptimit:

Aplikuesit duhet të vërtetoj se ata kanë ose do të kontraktajnë një subjekt i cili është në gjendje të ofrojë:

- Kapital të mjaftueshëm dhe siguri financiare, së bashku me procedurat për të siguruar garanci të kënaqshme për barazimet, të nevojshme për të shlyer dhe likuiduar shkëmbimin e energjisë që rezultojnë nga bashkimi tregut një-ditë-para dhe/ose ndërditor.
- Marrëveshjet teknike, operacionale dhe kontraktuale për të shlyer dhe likuiduar shkëmbimin e energjisë elektrike që rezultojnë nga bashkimi i tregut një-ditë-para dhe/ose ndërditor. Në veçanti, aplikuesit që aplikojnë për bashkimin e tregut një-ditë-para dhe/ose ndërditor duhet të vërtetojnë



që kanë ose do të nënshkruajnë marrëveshje operacionale dhe kontraktuale e cila lejon më shumë se një NEMO të operoj tregun e përbashkët një-ditë-para dhe/ose ndërditor.

Dokumentet e nevojshme si dëshmi:

Sipas rastit, aplikuesi pritet që të dorëzoj dokumentet mbështetëse si në vijim:

1. Përshkrim të detajuar për kostot operative dhe kërkesat e kolateralit si dhe mbajtja e tyre;
2. Përshkrim dhe shpjegim të qartë të procedurave për të vendosur se cilat garanci nevojiten për shlyerje/barazim;
3. Vlerësim i rrezikut dhe analiza e ndjeshmërisë e bërë për të treguar përballimin e riskut në vazhdim;
4. Përshkrim dhe shpjegim të qartë të mënyrës se si aplikuesi duhet të planifikoj të realizoj pagesën dhe shlyerjen, përfshirë:
 - a. Rregullat e aplikueshme;
 - b. Kërkesat e pjesëmarrësve,
 - c. Procedurat për shlyerjen/barazimin dhe likuidimin, përfshirë ato me NEMO dhe OST tjera.
5. Përshkrim dhe shpjegim i qartë për marrëveshjet kontraktuale që nevojiten për ofrimin e proceseve të shlyerjes dhe likuidimit, përfshirë ato me NEMO dhe OST tjera dhe konfirmimin për marrëveshjet e operimit dhe ato kontraktuale të cilat lejojnë NEMO dhe OST tjera të operojnë në tregun e bashkuar një-ditë-para dhe/ose atë ndërditor.

Kriteret e përcaktuara në Nenin 4, par.1, nënpar. 1.10:

Aplikuesi duhet të vendos sistemet e nevojshëm të komunikimit dhe praktikat për koordinim me KOSTT

Interpretimi i kuptimit:

Aplikuesit duhet të ofrojnë dëshmi se ata janë në gjendje të vendosin komunikimin e nevojshëm, sistemet teknike si dhe marrëveshjet përkatëse për koordinim me KOSTT.

Dokumentet e nevojshme si dëshmi:

Sipas rastit, aplikuesi pritet që të dorëzoj dokumentet mbështetëse si në vijim:

1. Përshkrimi dhe shpjegimi të mënyrës se si do të komunikohet me OST, përfshirë marrëveshjet e pronësisë dhe marrëveshjet kontraktuale për operimin dhe servisimin e këtyre pajisjeve;
2. Përshkrimi dhe shpjegimi i marrëveshjeve për rastet emergjente dhe menaxhim të rrezikut;
3. Dokumentin nga OST relevante ku konfirmohet pranimi i përshkrimit dhe shpjegimit të kërkuar më sipër dhe konfirmimi i tyre se kjo mënyrë, softueri dhe hardueri është kompatible për OST.